

SYLLABUS I LËNDËS: Bazat e menaxhmentit

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Bazat e menaxhmentit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Përcaktohet nga Dekanati
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Liridon Veliu
Detajet kontaktuese:	liridon.veliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë bazohet në vazhdimin e traditës dhe hulumtimit me bashkëkohor të lëndës së menaxhmentit si dhe aplikimi në mjedisin tonë që na rrethon, sfidat e menaxhmentit dhe menaxherëve të rinjë si dhe njohja me modalitetet me të reja në fushën e menaxhimit modern. Përfshinë metoda moderne dhe bashkëkohore të menaxhimit të organizatave duke u bazuar në parimet themelore të menaxhimit, si organizimi, udhëheqja, kontrolli, planifikimi, vendimmarrja. Si dhe strukturat organizatave të ndryshme dhe çështjet të cilat kanë lidhje direkte me menaxhimin bashkëkohor të ditëve të sotme me shembuj aktual dhe praktik lidhur me menaxhmentin. Përshkrimi i shkollave të ndryshme të menaxhimit dhe motivimi i punonjësve.
Qëllimet e lëndës	Përfitimi i njohurive themelore në lidhje me shkencën, teorinë, praktikën bashkëkohore dhe proceset e disiplinës së menaxhimit në sektorin privat dhe atë publik. Shpjegimi dhe nxënia e teorisë, proceseve, dhe funksioneve kryesore të menaxhimit.
Rezultatet e pritura të nxënies	Në fund studentët do jenë të aftë të: ✓ Kuptojnë çfarë përfshin menaxhmentit si proces dhe si strukturë ✓ Marrja e njohurive themelore në lidhje me procesin e komunikimit dhe direktivat mbi ndërtimin e strukturave organizative të suksesshme ✓ Identifikimi i roleve të udhëheqjes dhe organizimit në biznes ✓ Interpretimi i roleve nderpersonale që lidhen me krijimin dhe funksionimin e grupeve të punës ✓ Demonstrimi i njohurive mbi nocionet themelore të gjuhës së menaxhimit ✓ Të aplikojnë njohuritë themelore për menaxhimin, marrjen e vendimeve, funksionet menaxheriale, projektimin e punëve, si dhe aplikimin e teknikave menaxheriale për një menaxhim efektiv në praktikë

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime	1	15	15
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	20 min.	15	5
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokviume	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	2	6
Projekte, prezantime	1	4	4
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies	Ligjërata, ushtrime, diskutim në klasë, prezantim dhe debat i punimeve seminarike.		
Metodat e vlerësimit	Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes: a) vijueshmërisë në ligjërata dhe ushtrime: 10 pikë b) aktivitetit dhe punimi seminarik: 10 pikë c) testi i parë: 40 pikë d) testi i dytë: 40 pikë Gjithsej: 100 pikë Vlerësimi i provimit përfundimtar, që vlerësohet me 51% të suksesit, me një sistem të ndërtimit të mëtejshëm të notës përfundimtare me kriteret tjera të lartë theksuara.		
Literatura			
Literatura bazë:	Berim RAMOSAJ “Management /Bazat e menaxhimit”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2013		
Literatura shtesë:	- Shyqyri LLACI „Manaxhimi“, albPAPER, Tiranë, 2010 - Hellriegel, D., Slocum, J., Jackson, S.E., Louw, L., Staude, G., Amos, T. (2017), Management, Oxford University Press Soutern Africa (Pty) Ltd., Cape Town. - Stephen P. ROBBINS & David DeCenzo „Bazat menaxhimit, Koncepte dhe aplikime themelore, UET Press, Botimi i 7- të, Tiranë 2011; (Fundamentals of Management /”Essential Concepts and Applications /7 th Edition, 2011 - Stephen P. Robbins, Mary A. Coulter “Management” 13th-Ed, 2016, Pearson Education - Shyqri LLACI, Manaxhimi (Teste, ushtrime dhe raste studimore), 2008, FEUT, Tiranë		
Plani i dizajnuar i mësimi			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java e I-rë:	Menaxherët dhe menaxhimi		
Java e II-të:	Menaxhmenti si shkencë		
Java e III-të:	Mjedisi menaxherial		

<i>Java e IV-të:</i>	Menaxheri si planifikues dhe strateg
<i>Java e V-të:</i>	Organizimi si funksion i menaxhmentit
<i>Java e VI-të:</i>	Vendimmarrja / Teknikat ndihmëse në marrjen e vendimeve / Delegimi i vendimmarrjes
<i>Java e VII-të:</i>	Testi i pare
<i>Java e VIII-të:</i>	Personeli si funksion i menaxhmentit
<i>Java e IX-të:</i>	Menaxheri si udhëheqës
<i>Java e X-të:</i>	Motivimi dhe format e motivimit
<i>Java e XI-të:</i>	Kontrolli organizativ
<i>Java e XII-të:</i>	Trendët bashkëkohore të menaxhimit
<i>Java e XIII-të:</i>	Menaxhimi i ndryshimit, stresit dhe i risive
<i>Java e XIV-të:</i>	Përvojat e vendeve të ndryshme në zhvillimin e menaxhmentit
<i>Java e XV-të:</i>	Testi i dyte

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit.

Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata.

Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.